



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE



PAKETA FINANCIARE NR. 2

Procedurat, dokumentacioni dhe masa e përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe për të larguarit nga puna si pasojë e Covid-19.

Me synim përballimin e pasojave financiare të shkaktuara nga COVID – 19, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM-në nr.305 datë 16.04.2020 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19”, i ndryshuar.

Kjo paketë e njohur si “*Paketa Financiare Nr.2*”, përcakton subjektet përfitues, masën e përfitimit si dhe procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për t’u plotësuar nga këto subjekte përfitues. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 305, datë 16.04.2020 parashikohet dhënia e ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe të larguarit nga puna, për periudhën prill-qershor, si më poshtë:

Përfitues të ndihmës financiare në masën 40.000 lekë, e cila mbulon periudhën prill-qershor dhe është e pagueshme vetëm një herë si një shumë e vetme, janë:

- Të punësuarit në subjekte me të ardhura vjetore mbi 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë**, të mbyllura sipas Urdhrit/ave të të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), të cilët kanë qenë në punë në datën e hyrjes në fuqi të Urdhrit/ave të MSHMS, përfitojnë ndihmë financiare prej 40.000 (dyzetëmijë) lekë.
- Ish të punësuarit në subjektet që janë lejuar të kryejnë aktivitetet ose janë mbyllur** sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët janë larguar nga puna nga data 1 mars 2020 deri në datën 17 maj 2020.

3. **Të punësuarit e subjekteve me të ardhura vjetore deri në 14.000.000 (katërbëdhjetë milionë) lekë, të lejuara** për të ushtruar aktivitet sipas Urdhërit/ave të MSHMS, të cilët kanë qenë në punë që në datën e hyrjes në fuqi të Urdhërit/ave të MSHMS, përfitojnë ndihmë financiare prej 40.000 (dyzetëmijë) lekë. (Nuk përfshihen punonjësit përfitues sipas pikës 2).
 4. **Të punësuarit e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në sektorin e strukturave akomoduese**, të cilët figurojnë në listëpagesat e subjekteve, deri në datën e Urdhërit/ave të MSHMS, përfitojnë ndihmë financiare prej 40.000 (dyzetëmijë) lekë. Nëse subjekti ushtron disa lloje aktivitete, përfitojnë vetëm të punësuarit në aktivitetin e strukturës akomoduese.
- **Nuk përfitojnë ndihmë financiare sipas VKM nr.305 datë 16.04.2020:**
 1. Individët e punësuar, të cilët për vitin 2019 kanë realizuar të ardhura bruto nga paga mbi 2.000.000 (dy milionë) lekë;
 2. Punonjësit e institucioneve shtetërore si dhe të punësuarit në shoqëritë me kapital shtetëror;
 3. Punonjësit e organizatave jofitimprurëse;
 4. Individët e subjekteve me objekt veprimtarie: tregti të produkteve ushqimore, fruta – perime, aktivitetet farmaceutike. Gjithashtu, nuk përfitojnë edhe individët e dypunësuar, ku njëri prej aktiviteteve bën pjesë në këtë kategori subjektësh;
 5. Individët e subjekteve të regjistruara si persona fizikë, të cilët ushtrojnë aktivitet sipas profesioneve të tilla si: avokat, noter, mjek i specializuar, farmacist, infermier, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, ekspert kontabël i regjistruar, kontabilist i miratuar dhe vlerësues i pasurisë, që lejohen të kryejnë aktivitetin sipas urdhërit/ve të MSHMS. Gjithashtu, nuk përfitojnë edhe individët e dypunësuar, ku njëri prej aktiviteteve bën pjesë në këtë kategori subjektësh;
 6. Punonjësi/it të cilët përfitojnë sipas VKM nr.254, datë 27.03.2020, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masën e përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike dhe të pagesës të të ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore të shpallur si pasojë e COVID-19”.
 7. Të punësuarit apo të ish-punësuarit, të cilët përfitojnë ndihmën financiare sipas këtij vendimi, përjashtohen nga përfitimi njëkohësisht nga paketat e mbështetjes shtetërore të pagesës së ndihmës ekonomike si dhe të pagesës të së ardhurës nga papunësia, mbështetur në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, sipas të cilit nuk lejohet përfitimi në të njëjtën kohë nga dy skema të mbështetjes shtetërore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

- Procedura dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës financiare

Subjektet përfitues duhet të paraqesin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet portalit e-filing formularin “Kërkesë për përfitim të ndihmës financiare 2”, me **të dhënat e përfituesve** dhe është më pas Administrata Tatimore, e cila brenda 10 ditëve pune nga data e aplikimit, verifikon dhe analizon nëse këta subjekte plotësojnë kriteret për të përfituar nga ndihma financiare.

Të dhënat e përfituesve:

1. Të dhënat e subjektit tatimpagues;
2. Të dhënat identifikuese të përfituesve;
3. Bankën dhe numrin e llogarisë bankare të përfituesve.

VKM Nr. 423, datë 28.05.2020 parashikon se në rastet e mosaplikimit nga ana e subjektit, ndihma financiare për të punësuarit apo ish-të punësuarit do të jepet menjëherë pas miratimit nga administrata tatimore.

Referenca:

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.305, datë 16.4.2020 “Për Përcaktimin E Procedurave, Të Dokumentacionit Dhe Të Masës Së Përfitimit Të Ndhmës Financiare Për Të Punësuarit Aktualë Dhe Punonjësit E Larguar Nga Puna Si Pasojë E Covid-19” (Ndryshuar me VKM nr. 341, datë 23.4.2020).

<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/04/16/305/19776fdf-bc9c-4d68-9332-d1ba38f5c463>

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.423, datë 28.5.2020 “Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr.305, Datë 16.4.2020, Të Këshillit Të Ministrave, “Për Përcaktimin E Procedurave, Të Dokumentacionit Dhe Të Masës Së Përfitimit Të Ndhmës Financiare Për Të Punësuarit Aktualë Dhe Punonjësit E Larguar Nga Puna Si Pasojë E Covid-19”.

<https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/97/4f8efe11-ded6-42a3-951b-59a24dff5ba>